



Tel: +355 4 2269097

Fax:

E-Mail: info@dpa.gov.al

Rregullore e Grupeve Teknike të Punës

Kodi DA-RG-003

Rishikim nr 2

Dt: 27.07.2015

Faqe 1 nga 6

RREGULLORE E GRUPEVE TEKNIKE TË PUNËS

Zbatues: Anëtarët e grupeve teknike të punës, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit, Sekretariati.

Përgjegjës për zbatimin: Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit.

Kontrolloi : Armond HALEBI

Drejtori i Përgjithshëm

Miratoi : Arben AHMETAJ

Ministri i MZHETTS



Tel: +355 4 2269097

Fax:

E-Mail: info@dpa.gov.al

Rregullore e Grupeve Teknike të Punës

Kodi DA-RG-003

Rishikim nr 2

Dt: 27.07.2015

Faqe 2 nga 6

1. Parimet e përgjithshme

1.1 Grupet teknike të punës pranë DPA-së krijohen në bazë të pikës 13 të nenit 9 të Ligjit Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 667, datë 29.7.2015 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit” dhe Standardit Ndërkombëtar S SH EN ISO/IEC 17011:2004 “Kërkesa të përgjithshme për organizmat akreditues që akreditojnë organizma të vlerësimit të konformitetit”, paragrafi 4.2.7.

1.2 Roli i grupeve teknike të punës është të hartojë kërkesat e veçanta për akreditimin në fushën përkatëse.

1.3 DPA krijon grupe teknike të punës sipas fushave ku ofron shërbimin e akreditimit.

1.4 Anëtarët e grupeve teknike të punës emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas verifikimit të përputhshmërisë të kriterëve të vëna për anëtarët. Numri i anëtarëve nuk është i kufizuar por nuk lejohet mbizotërimi i një pale.

1.5 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për përmbushjen e detyrave të saj krijon katër grupe teknike të punës:

- Për laboratorët testues dhe kalibrues,
- Për laboratorët mjekësorë,
- Për organet certifikues,
- Për organet inspektues.

1.6 Për çështje specifike çdo grup teknik i punës mund të propozojë krijimin e nëngrupeve sektoriale në varësi të fushave për të cilat kërkohet akreditimi. Ky propozim miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

1.7 Si palë të përfaqësuara në grupet teknike të punës të DPA-së rekomandohet të përfshihen;

1. Vlerësuesit e DPA-së.

2. Specialistë të organeve miratuese dhe liçensuese.



Tel: +355 4 2269097

Fax:

E-Mail: info@dpa.gov.al

Rregullore e Grupeve Teknike të Punës

Kodi DA-RG-003

**Rishikim nr 2
Dt: 27.07.2015**

Faqe 3 nga 6

3. Specialistë pranë OVK-ve të Institucioneve Publike.
4. Personeli i DPA-së.
5. Organe të Akredituara nga DPA.
6. Klientë të Organeve të akredituara nga DPA.
7. Specialistë të njohur të fushës.
8. Specialistë pranë Organizmave të Mbikqyrjes së Tregut.
9. Përfaqësues të Institucioneve mësimdhënëse/akademike.

2. Kriteret për anëtarët e grupeve teknike të punës

Anëtarët e grupeve teknike të punës duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë ekspertë të fushës përkatëse;
- të njohin punën që bëhet në fushat që ato mbulojnë;
- të jenë përfaqësues të një ose disa palëve të interesuara;
- të njohin legjislacionin në fuqi për fushat që grupi teknik i punës mbulon;
- të jenë të interesuar për zhvillimin e akreditimit në Shqipëri;
- të kenë kryer kurse trajnimi në lidhje me çështje të përgjithshme të menaxhimit të organeve të vlerësimit të konformitetit apo për çështje specifike që kanë lidhje me këto organe;
- të ruajnë konfidencial të gjithë informacionin e fituar si anëtarë të grupit teknik të punës;
- të kenë aftësi të punojnë në grup;
- të kenë aftësi të mira komunikimi.

3. Detyrat e grupeve teknike të punës:

Seicili grup teknik i punës ka për detyrë të:



Tel: +355 4 2269097

Fax:

E-Mail: info@dpa.gov.al

Rregullore e Grupeve Teknike të Punës

Kodi DA-RG-003

**Rishikim nr 2
Dt: 27.07.2015**

Faqe 4 nga 6

- 1- Të propozojë për përdorim të udhëzuesve të organizmave ndërkombëtarë të akreditimit dhe të palëve të përfshira në përputhje me procedurat e akreditimit.
- 2- Të diskutojë e bashkëpunojë me DPA-në në hartimin e kërkesave të veçanta për fusha shumë specifike të cilat përdoren nga vlerësuesit teknikë të DPA-së gjatë vizitave vlerësuese.
- 3- Të jap sygjerime për identifikimin vlerësuesve ose burimeve për vlerësues si dhe për kërkesat e specializuara për vlerësuesit në fushën e akreditimit.
- 4- Të ndihmojë në trajnime (me ndihmën e DPA-së) për rritjen e kualifikimit të vlerësuesve teknikë të saj në fushat përkatëse.
- 5- Të mbështesë DPA-në në lidhje me interpretimin e rezultateve të pjesëmarrjes në krahasimet ndërlaboratorike apo testet e zotësisë.
- 6- Të mbështesë krijimin e rregjistrit të vlerësuesve teknikë të DPA-së.
- 7- Të shkëmbejë eksperiencën midis vlerësuesve teknikë.
- 8- Me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të DPA-së grupi teknik i punës mund të japë rekomandime apo këshilla në lidhje me çështje teknike që kanë të bëjnë me marrjen e vendimit të akreditimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm.
- 9- Jep rekomandim për akreditimin e organeve të lidhura
- 10- Të kontribuojë në promovimin e akreditimit të fushës përkatëse.
- 11- Të diskutojë drafte dhe dokumenta të nxjerra nga EA, ILAC dhe IAF për fushën përkatëse.
- 12- Të ndihmojë në formulimin e pikpamjeve të DPA-së për dokumenta të rinj.
- 13- Të marrë pjesë në grupe pune të ngritura nga DPA për çështje të veçanta të akreditimit.

4. Funksionimi i grupit teknik të punës

- 4.1 Grupi teknik i punës mblidhet me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm, me kërkesë të kryetarit të grupit teknik të punës ose me kërkesën e të paktën tre anëtarëve. Është detyrë e sekretariatit të DPA-së të lajmërojë anëtarët e grupit teknik të punës.



Tel: +355 4 2269097

Fax:

E-Mail: info@dpa.gov.al

Rregullore e Grupeve Teknike të Punës

Kodi DA-RG-003

**Rishikim nr 2
Dt: 27.07.2015**

Faqe 5 nga 6

4.2 Axhenda e takimit shpërndahe të paktën pesë ditë punë më parë se takimi nga sekretariati i DPA-së.

4.3 Takimet zhvillohen pranë zyrave të DPA-së.

4.4 Në takimin e parë anëtarët zgjedhin një kryetar dhe një nënkryetar të grupit teknik të punës, me shumicë votash, të cilët kanë mandat dy vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje një herë. Grupi teknik i punës ka të drejtë që të thërrasë në mbledhje punonjës ose vlerësues të DPA-së sidomos kur diskutohen çështje të hartimit të procedurave të akreditimit si dhe përfaqësues të palëve të interesuara. Thirrja e punonjësve ose vlerësuesve të DPA-së bëhet me kërkesë tek Drejtori i Përgjithshëm.

4.5 Në rast vendimesh, ato merren me shumicë të thjeshtë.

4.6 Informacioni i diskutuar në mbledhje është konfidencial. Çdo anëtar i grupit teknik të punës nënshkruan Deklaratën e Konfidencialitetit DA-FO-010.

4.7 Në rastin e dhënies së rekomandimit për akreditim, anëtarët që kanë lidhje apo konflikt interesi me çështjen që po diskutohet, nuk marrin pjesë në votim.

5. HISTORIKU

Data ripunimit.	Numri i rishikimit.	Hartoi	Përshkrimi i ndryshimeve.
30.10.2006	0	Ardita FUGA	Varianti fillestar
25.01.2010	1	Arben ISAKU	Janë bërë ndryshime në pikën 1.1 duke iu referuar dhe dokumentacionit ligjor, në pikën 1.3 është hequr nr. fiks i krijimit të komiteteve kjo duke ju referuar edhe legjislacionit në fushën e akreditimit. Në pikën 2.6 janë shtuar kërkesa në lidhje me trajnimin e anëtarëve të komiteteve teknike. Pikat 3.8 dhe 3.9 i është dhënë kompetenca të shprehin mendim në vendimarrje, në proceset e akreditimit. Pika 4 është hequr krijimi i nën grupeve brenda komiteteve.



Tel: +355 4 2269097

Fax:

E-Mail: info@dpa.gov.al

Rregullore e Grupeve Teknike të Punës

Kodi DA-RG-003

Rishikim nr 2

Dt: 27.07.2015

Faqe 6 nga 6

	2	Suela MUSTAFARAJ	Janë bërë ndryshime në pikën 1.1, 1.3, 1.7 në përputhje me Ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë” si dhe është shtuar pika 1.5, 1.6 dhe 4.7.
--	---	---------------------	--